



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME / SPECIJALNA KOMORA VRHOVNOG SUDA / SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT
Pallati i Drejtësisë, Objekti A, Rruga Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palata Pravde, Objekt A, Ulica Nekibe Kelmendi, 10510 Hajvali / Palace of Justice, Building A, Nekibe Kelmendi Street, 10510 HajvaliVËRTETIMI MBI DORËZIMIN E
DOKUMENTIT

Duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-033 për
Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të
Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë
Kosovare të Privatizimit, pala e nënshkruar
më poshtë vërteton pranimin e dokumentit:

Ndërmarrja: Preduzeće: Enterprise:

1. Muharrem Bekteshi

• Socially Owned Enterprise • Artizanship and
Construction • Mitrovicë

Paditës

Tužilac

Claimant

I paditur

Tuženi

Respondent

POTVRDA O DOSTAVI
DOKUMENTA

Na osnovu Zakona br. 04/L-033 o
Specijalnoj komori Vrhovnog suda Kosova
za pitanja koja se odnose na Kosovsku
agenciju za privatizaciju, dole potpisana
stranka potvrđuje dostavu dokumenta
navedenog dole:

Numëri i lëndës: Broj predmeta: Case Number:

C-IV.-24-0106

ACKNOWLEDGEMENT OF
RECEIPT OF A DOCUMENT

Pursuant to Law no 04/L-033 on Special
Chamber of the Supreme Court of Kosovo
on Privatization Agency of Kosovo Related
Matters, the below signed party
acknowledges receipt of the document
described below:

Data e regjistrimit: Datum registrovanja: Date registered:

09/07/2024

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT - KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU	
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO	
II	
2758	
Nr. i Fq.	Data: 10. 07. 2024
Br. Str.	Datum:
Ko. Pg.	Date:
Përfaqësues	Prishtinë / Pristina
Punomočnik	
Representative	

#	Titulli i Dokumentit:	Naziv dokumenta:	Document Name:	Datë Datum Dated
1	Aktvendim nga Dhoma	Rešenje komore	Decision of the Chamber	08/07/2024

Pala:	Stranka:	Party:
Pranuar nga:	Primio:	Received by: Agjencia Kosovare e Privatizimit - Prishtinë
Titulli:	Zvanje:	Title:
Data:	Datum:	Date: 10. 07. 2024
Nënshkrimi	Potpis:	Signature: [Signature]



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO



Numri i lëndës: 2024:187572
Datë: 08.07.2024
Numri i dokumentit: 05911947

C-IV-24-0106

08 korrik 2024

Parashtruesi i kërkesës

Autoriteti i Likuidimit (AL), i Ndërmarrjes Shoqërore MIT148 Ndërmarrja Shoqërore
“Ndërmarrja Zejtare Ndërtimore” në likuidim në Mitrovicën e Jugut

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Parashtruesin e kërkesës

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë
Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Hajrie Shala, me 08 korrik 2024,
lëshon këtë:

AKTVENDIM

- Aprovohet** Raporti Përfundimtar i AL-së të Ndërmarrjes Shoqërore MIT148 Ndërmarrja Shoqërore “Ndërmarrja Zejtare Ndërtimore” në likuidim, në Mitrovicën e Jugut
- Lejohet** mbyllja e rastit të likuidimit ndaj kësaj Ndërmarrje .
- Lirohet** AL nga çdo detyrë e mëtutjeshme në lidhje me procedurat e likuidimit, përveç për ekzekutimin e ndonjë shpërndarjeje përfundimtare që nuk është realizuar ende.



Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 03 korrik 2024, parashtruesi i kërkesës ka dorëzuar në Dhomën e Posaçme raportin përfundimtar të likuidimit të Ndërmarrjes Shoqërore (tani e tutje NSH) të Ndërmarrjes Shoqërore MIT148 Ndërmarrja Shoqërore “Ndërmarrja Zejtare Ndërtimore Muharrem Bektashi” në likuidim në Mitrovicën e Jugut duke propozuar që pas shqyrtimit të aprovoj Raportin Përfundimtar dhe të bie vendim mbi lejimin e mbylljes së rastit të likuidimit ndaj kësaj ndërmarrje. Parashtruesi i kërkesës më tej ka pohuar se këtë kërkesë e paraqet në pajtim me nenet 43 dhe 44 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (më tutje: Shtojca e Ligjit të AKP-së).

Arsyetimi ligjor

Dhoma e Posaçme, pas shqyrtimit të kërkesës, konstaton se kërkesa është e bazuar dhe si e tillë duhet të aprovohet.

Sipas nenit 43 paragrafi 1, të Shtojcës së Ligjit të AKP-së, Autoriteti i Likuidimit, pas përfundimit të plotë apo përfundimit substancial të realizimit të pronës së Ndërmarrjes sipas likuidimit, apo pas mbylljes së rastit të Likuidimit, ia parashtron raportin përfundimtar Dhomës së Posaçme.

Paragrafi 2 i këtij neni përcakton se Raporti përfundimtar përmban:

- 2.1. një listë të të gjitha pronave të shitura apo të zgjidhura në mënyra tjera,
- 2.2. një listë të fletëpranimeve dhe pagesave të parasë së gatshme,
- 2.3. një listë përfundimtare të të gjitha kërkesave të lejuara,... dhe
- 2.4. një listë të balancit të mbetur në llogarinë bankare me shpjegim të qëllimit;

Paragrafi 3, i këtij neni përcakton se: *Autoriteti i Likuidimit dërgon njoftim të aprovimit të Raportit Përfundimtar nga ana e Gjykatës të kreditorët, komiteti i kreditorëve (nëse ekziston) brenda pesë (5) ditëve pas pranimit të aprovimit të Gjykatës për mbylljen e rastit të likuidimit.*

Neni 44 paragrafi 1, i Shtojcës së Ligjit të AKP-së, parasheh që përveç rasteve të rregulluara në paragrafët 2 dhe 3 të këtij neni, mbyllja e rastit ndodh kur Gjykata aprovon raportin përfundimtar të Autoritetit të Likuidimit sipas nenit 43 të kësaj Shtojce.

Me 12 janar 2017, Bordi i Drejtorëve të AKP-së ka nxjerr vendim për themelimin dhe përbërjen e Autoritetit të Likuidimit për NSH “Ndërmarrja Zejtare Ndërtimore Muharrem Bektashi ” në likuidim në Mitrovicën e Jugut, përbërja e të cilit ishte ndryshuar më vonë 30 shtator 2019.

Me 23 janar 2017, Autoriteti i Likuidimit pasi ka iniciuar procesin e likuidimit të kësaj NSH-je, ka publikuar Njoftimin e parë për fillimin e Likuidimit në gjuhën shqipe dhe serbe në gazetën Koha Ditore dhe Kosova Sot dhe në gjuhën serbe në gazetën Danas dhe Vjesti, në Serbi. Njoftimi të dytë ishte bërë me dt.01 shkurt 2017 gazetën e përditëshme Koha Ditore dhe Kosova Sot dhe në gjuhën serbe në gazetën Danas dhe Vjesti në Serbi, poashtu Bordi i



drejtorëve kishte vendosur që të gjitha njoftimet për kreditorët e AKP-së të bëhen në web faqen e AKP-së të cilat edhe janë bërë. Raportit i janë bashkëngjitur dëshmitë e publikimit të këtyre njoftimeve.

AL ka dërguar njoftimet përkatëse për fillimin e Likuidimit të kësaj NSH-je tek institucionet relevante dhe kreditorët potencialë. Me 26 janar 2017, janë njoftuar Agjencia për Regjistrimin e Bizneseve, Zyra për Regjistrimin e Pengut e kësaj Agjencie, Administrata Tatimore e Kosovës, Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe KK Mitrovicë, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë. Në të njëjtën kohë ishte njoftuar Kuvendi Komunal Mitrovicë - Zyra e Tatimit në Pronë si dhe disa kreditorë tjerë. Me 26 janar 2017 për fillimin e likuidimit ndaj kësaj NSH-je ishin njoftuar degët e bankave në Mitrovicë siq janë TEB, NLB, BKT, Ekonomike, Banka komerciale A.D. Beograd dega në Mitrovicë dhe gjykatat si: Gjykata Themelore në Mitrovicë dhe degët e saj Vushtrri, Skenderaj, Leposaviq dhe Zubin Potok, Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për çështje ekonomike, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme e Kosovës si dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës.

AL i NSH-së nuk ka identifikuar se kjo ndërmarrje ka në pronësi asete të palujtshme apo të lujtshme të cilat do të mund të realizonin të hyra nga procesi i likuidimit. Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Komuna e Mitrovicës -Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër kanë konfirmuar se NSH-ja nuk ka regjistruar kurrfarë prone të patundshme në emër të NSH-së.

Me shkresën e datës 22 mars 2017, Komuna e Mitrovicës, Drejtoria për Ekonomi dhe Financa përkatësisht Zyra e Përhershme e Tatimit në Pronë, ka konfirmuar se NSH-ja nuk ishte e ngarkuar me tatim në pronë dhe rrjedhimisht nuk ka asnjë obligim ndaj Zyrës së Tatimit në Pronë për faktin se kjo NSH nuk ka afaruar në asnjë periudhë tatimore dhe si rezultat i kësaj nuk ka të krijuara as obligime nda Administratës Tatimore të Kosovës.

Ndërsa kërkesa e Drejtorisë për Financa dhe zhvillim ekonomik për pagesën e tatimit në pronë sipas faturës nr. 3355019926 e dt.18 prill 2024 për MIT148 NSH "Ndërmarrja Zejtare Ndërtimore Muharrem Bekteshi" në Mitrovicën e Jugut, është ushtruar pas afatit ligjor për parashtrimin e kërkesave.

AL në Pasqyrën Përfundimtare Financiare ka deklaruar se të ardhurat nga privatizimi dhe shitja e aseteve përmes likuidimit janë zero (0) €, për faktin se ndërmarrja në fjalë nuk ka pas ndonjë pasuri në posedim ose pronësi, ndërsa shpenzimet e likuidimit kanë arritur vlerën prej 1,104.80 € të mbuluara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, që përfshijnë shpenzimet e njoftimeve dhe shpenzime të tjera operative.

Me 19 prill 2024, AL kishte njoftuar kreditorët potencialë për mungesën e fondeve për përmbushjen e kërkesave kreditore ndaj NSH-së. Dhoma e Posaçme ka konfirmuar se nuk ka ndonjë padi ndaj kësaj NSH-je.

Meqenëse nuk ka mjete financiare në dispozicion pasi NSH nuk kishte asete për shitje, gjykata në pajtim me nenin 47 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së vendosi se kërkesat e tilla kreditore shuhen me ligj dhe çdo veprim për të inkasuar borgjet e tilla ndalohet.

AL mbetet përgjegjës për veprimet apo lëshimet joligjore gjatë mandatit të tij, sipas nenit 46 paragrafi 2 të Shtojcës së Ligjit të AKP-së.

Prandaj, u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

